




Meningjitet dhe septicemitë e meningjokokut

5 arsyt e forta për tu vaksinuar

Vaksinimi i 11-14 vjeçarëve




Një rritje e rëndësishme e rasteve të infeksioneve invazive të meningjokokut (meningjit dhe septicemi) është vërejtur që nga viti 2023, në veçanti lidhur me meningjokokët e tipit W dhe Y.

Duke marrë parasysh faktin se këto infeksione mund të jenë shumë të rënda, vaksinimi rekomandohet për të gjithë adoleshentët nga mosha 11 deri në 14 vjeç.

Çfarë është infeksioni invaziv i meningjokokut ?

—◆—
Në Francë, rreth 500 deri 600 persona preken çdo vit nga një infeksion invaziv i meningjokokut.

- Është një sëmundje shumë e rëndë si meningjiti apo septicemia që mund të shkaktojë vdekjen ose të lërë pasoja të rënda (shurdh, vonesa mendore, prerjen e një gjymtyre...).
- Ajo shkaktohet nga një bakterie, meningjokoku i cili paraqet disa tipa : A, B, C, W dhe Y. Në Francë meningjokokët më të përhapur janë ata të tipit B, W dhe Y.
- Meningjokokët janë bakterie të pranishme në grykën dhe hundët të mjaft personave por që nuk shkaktojnë me doemos sëmundje. Këto bakterie mund të transmetohen nga kontakti nga afër, të zgjatur ose të përsëritur me një person të infektuar.
- Përpos foshnjeve për të cilat vaksinimi është i detyrueshëm, adoleshentët si dhe të rinjtë janë veçanërisht të prekur.
- Vaksinat kundër meningjokokëve A, C, W, Y, të sigurta dhe efikase, janë këtej e tutje në dispozicion.



Kujt i drejtohet vaksinimi ?

Vaksinimi kundër meningjokokëve A,C,W,Y këshillohet për adoleshentët nga 11 deri 14 vjeç, cilat do qofshin vaksinat kundër meningjokokëve që mund të kenë bërë më parë. Vaksinimi këshillohet gjithashtu si përsëritje pas moshës 14 vjeç, deri në moshën 24 vjeç.

Një injeksion i vetëm i mbron adoleshentët të paktën për 5 deri 10 vjet. Vaksina mund të bëhet njëkohësisht me vaksinat e tjera të adoleshentit : përsëritja e difteri-tetanos- kolla e mirë-poliomelit dhe vaksina kundër papilomavirus (HPV).

Cilat janë vaksinat në dispozicion ?

Tre vaksina mund të përdoren për adoleshentët : vaksinat Nimenrix®, Menquadfi® dhe Menveo®.

Cilat janë efektet dytësore ?

- Këto vaksina mund të shkaktojnë një reaksion në vendin e injeksionit (dhimbje, skuqe, ënjtje) dhe simptoma si ethe, nervozizëm apo dhimbje koke. Këto efekte janë pa rëndësi dhe të përkohshëm.
- Si për të gjitha vaksinat, reaksione alergjike të rënda janë shumë të rralla por gjithësesi të mundshme.

Sa kushton vaksina ?

Vaksinat kundër meningjokokëve A, C, W, Y mbulohen në masën 65 % nga sigurimet shëndetësore. Pjesa tjetër rimburohet nga siguri shëndetësor plotësues. Personat që përfitojnë nga CSS dhe AME nuk kanë asgjë për të paguar.

Ku mund të vaksinohesh ?

- Në shkollë.
- Te mjekët e përgjithshëm, pediatri, mamitë, infermierët, në farmaci apo në një qendër vaksinimi.

—●—
Duke filluar nga viti i ri skollor 2025, vaksina kundër meningjokokëve A, C, W, Y u propozohet falas nxënësve të shkollës 9 vjeçare, njëkohësisht me vaksinën kundër HPV.

Një pyetje, një këshillë ? Flisni me një profesionist të shëndetit.

Vaksina efikase

Të dhënat e shteteve që vaksinonin kundër infeksioneve invazive të meningjokokut A, C, W, Y vërtetojnë efikasitetin e lartë të vaksinave në fjalë.

Vaksina të nevojshme

Ato mbrojnë adoleshentët kundër meningjokuteve dhe septicemive që shkaktojnë meningjokokët A, C, W, Y dhe shmangin ndërlikimet e këtyre sëmundjeve që mund të jenë shumë të rënda.

Duke përgatitur adoleshentët e vaksinuar të infektohen dhe të infektoshin kështu persona të tjerë, vaksinimi mbron jo vetëm adoleshentin e vaksinuar por edhe mjedisin që e rrethon.

Vaksina të thjeshta

Një injeksion i vetëm mjafton për të mbrojtur adoleshentët deri në moshën madhore. Vaksinat mund të bëhen njëkohësisht me vaksinat e tjera të moshës.

Vaksina pa rrezik

Reaksionet janë të rrallë dhe pa rëndësi.

Vaksina të marra përsipër

Sigurimet Shëndetësore mbulojnë 65 % të vaksinës, dhe sigurimet plotësues pjesën që mbetet. Vaksinimi mund të bëhet falas në disa qendra të shëndetit, të vaksinimit apo në shkollë.

